



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË GJILANIT PËR VITIN 2023

Prishtinë, maj 2024

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Gjilanit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Gjilanit (KGJ), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Gjilanit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Komuna kishte bërë keqklasifikim të shpenzimeve në kategoritë e ndryshme ekonomike në vlerë prej 481,689€.
- B2 Pasuria jo kapitale e prezantuar 2,259,413€, në nenin 19.3.2 në Raportin Vjetor Financiar nuk është e plotë dhe e saktë pasi që komuna nuk e kishte regjistruar pasurin jokapitale në regjistrat kontabël të pasurive.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Gjilanit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

## Baza për konkluzion

- A1 Pagesa e projekteve në kundërshtim me ligjin e buxhetit.
- A2 Komuna kishte anashkaluar procedurat e prokurimit për punimin e skulpturave monumentale, vlera e pagesës për këtë projekt ishte 113,770.60€
- B3 Komuna kishte angazhuar të punësuar me kontratë për shërbime të veçanta pa i respektuar procedurat e prokurimit publik.
- B4 Komuna nuk kishte arritur ta bëjë inspektimin (verifikimin) për të paktën 20% e të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës.
- B5 Shuma e pagesave të realizuara nga thesari, në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbartimore për shpronësime dhe faturat e vonuara ishte 732,672€. Prej tyre borxhi kryesor ishte 723,146€ ndërsa 9,526€ ishin shpenzime të interesit dhe procedurale të gjykatës/përmbartimit.
- B6 Mos respektim i hapave për procedimin e pagesave

*Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

## **Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Gjilanit.

## **Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Komunës së Gjilanit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Gjilanit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

## **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Gjilanit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Gjilanit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, kemi identifikuar fusha në të cilat nevojiten përmirësime në menaxhimin financiar dhe kontrollin. Në veçanti, kemi identifikuar dobësi në fushën e, të hyrave dhe llogarive të arkëtushme, obligimeve të papaguara, klasifikimin e shpenzimeve, menaxhimin e pasurive si dhe në procedurat e prokurimit publik. Këto çështje janë paraqitur si gjetje dhe rekomandime të mëposhtme për t'u shqyrtuar.

Rekomandimet e paraqitura më poshtë, synojnë të përmirësojnë kontrollin e brendshëm në lidhje me menaxhimin dhe kontrollin financiar, duke respektuar autoritetin që lidhet me menaxhimin e fondeve në sektorin publik. Plani ynë është të rishikojmë dhe të ndjekim këto rekomandime gjatë procesit të auditimit për vitin e ardhshëm.

Raporti ynë ka rezultuar me 11 rekomandime prej tyre 3 janë rekomandime të reja, 8 të përsëritura, për përmirësimin e këtyre aspekteve të menaxhimit financiar dhe kontrolleve.

Shuma e pagesave të realizuara nga Thesari, në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbarimore për kontratën kolektive ishte 1,258,605€. Prej tyre borxhi kryesor ishte 1,156,149€, ndërsa 102,456€ ishin shpenzime të interesit dhe procedurale të gjykatës/përmbarimi.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

### 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

#### Çështja B1 - Keqklasifikim i shpenzimeve

##### Gjetja

Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF “Mbi shpenzimin e parasë publike” shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Nga testimi i mostrave, kemi vërejtur keqklasifikime të shpenzimeve nëpër kategori ekonomike në vlerë 481,689€. Nga kjo vlerë, thesari kishte paguar sipas vendimit përmbarimor të gjykatës për paga jubilarë dhe shujta për arsimtar nga kategoria e investimeve kapitale 379,467€ dhe nga kategoria mallrave dhe shërbimeve 102,222€. Pagesat nga kategoritë ekonomike jo adekuate janë ekzekutuar nga Thesari, në fund të vitit 2023, komuna kishte bërë kërkesës në Ministri për aprovimin e buxhetit shtesë në kategorinë e pagave dhe shtesave kjo nuk kishte ndodhur.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së ndarjeve buxhetore në kategorinë ekonomike adekuate për ti realizuar pagesat e vendimeve gjyqësore përmbarimor.

##### Ndikimi

Pagesat e bëra nga kategoria jo-adekuate, shpjen në paraqitjen e shënimeve të gabuara në Pasqyrat Financiare të Komunës, ku të dhënat për kategori të shpenzimeve nuk janë të sakta dhe si të tilla japin informata çorientuese për shfrytëzuesit e PVF-ve.

##### Rekomandimi B1

Kryetari duhet të sigurojë që në kordinim me Ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që

shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestnimi i mjeteve që pagesa dhe regjistrimi i transaksioneve të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B2 - Mos përdorimi i programit të e-pasurisë dhe mungesë e regjistrave për pasurinë nën 1,000€**

##### **Gjetja**

Rregullorja MF-NR. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, Neni 6.1. përcakton se, "Çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël. Po ashtu neni 6.3. përcakton se, Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria".

Nga testimi i mostrave ka rezultuar se pasuria jo kapitale nën 1,000€ nuk ishte regjistruar në sistemin e-pasurisë apo në ndonjë regjistër të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël. Po ashtu Komuna në mungesë të regjistrimit nuk i ka shpalosur këto pasuri në aneksin e RVF-së. Prandaj, si rezultat i mungesës së regjistrave kontabël, ne nuk ishim në gjendje të vlerësojmë plotësin dhe saktësinë e pasurisë nën 1,000€, të raportuara në vlerë 2,259,413€, në nenin 19.3.2 në Raportin Vjetor Financiar.

Kjo ka ndodhur si rezultat i një sistemi jo efektiv të kontrolleve dhe monitorimit të zyrtarëve që merren me menaxhimin e pasurive jo financiare.

##### **Ndikimi**

Mos regjistrimi i pasurisë jo financiare sipas kriterëve të përcaktuara në rregulloren për menaxhimin e pasurisë jo financiare, ndikon humbjen a po tjetërsimin e pasurisë dhe prezantimin e informatave jo të plota në pasqyrat financiare.

##### **Rekomandimi B2**

Kryetari duhet të shtojë kontrollet e brendshme për tu siguruar se zyrtarët e pasurive do ta regjistrojnë pasurinë jo kapitale në sistemin e-pasurisë me qëllim të prezantimit të plotë dhe të saktë të tyre në PVF.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**



## 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja A1 - Pagesa e projekteve në kundërshtim me ligjin e buxhetit.

**Gjetja** Sipas Ligji i buxhetit nr. 08/L-192 neni 9, pika 2 - Jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas lëshimit të ndarjeve buxhetore të plota për vitin fiskal 2023, Qeveria dorëzon në Kuvend për informim tabelën që tregon ndryshimet e bëra në tabelën 4.2 (financimi i investimeve kapitale komunale), që kërkohet nga organizatat buxhetore për të përmbushur obligimet e pakryera financiare nga viti paraprak

Nga mostrat e testuar, kemi vërejtur se në tri (3) raste janë kryer pagesat nga fondet e projekteve të aprovuar në ligjin e buxhetit 2023 për projekt tjera.

- Kontrata për projektin "Asfaltimi i rrugëve në Lagjen e Vishnjeve, pjesa I", është nënshkruar në vitin 2022 në vlerën prej 199,878€, bazuar në ndarjet buxhetore të vitit. Megjithatë, projekti nuk ishte realizuar në tërësi gjatë vitit 2022. Si rezultat i kësaj, në vitin 2023, komuna ka kryer pagesat për këtë projekt në vlerën prej 18,582€, duke shpenzuar fondet e projektit "Ndërtimi i rrugëve në fshatrat e zonës lindore dhe në zonën e tretë të qytetit".
- Kontrata për projektin "Asfaltimi i rrugëve në lagjen Arbëria" e nënshkruar në vitin 2022 në vlerë prej 165,480€, bazuar në ndarjet buxhetore të vitit. Megjithatë, projekti nuk ishte realizuar në tërësi gjatë vitit 2022. Si rezultat i kësaj, në vitin 2023 komuna ka kryer pagesë për këtë projekt në vlerë 70,660€ duke shpenzuar fondet e projektit "Ndërtimi i kanalizimeve fekale dhe gropave skeptike në zonën lindore".
- Kontrata për projektin "Mirëmbajtja teknike e objekteve" e nënshkruar në vitin 2021 në vlerë 1,871,560€, bazuar në ndarjen buxhetore të vitit. Megjithatë, projekti nuk ishte realizuar në tërësi gjatë vitit 2022, si rezultat i kësaj në vitin 2023 komuna për këtë projekte ka kryer pagesë në vlerë 18,456€ nga fondet e projektit "Ndërtimi dhe shtrirja e ndriçimit publik në zonën e tret të qytetit të Gjilanit".

Zyrtaret përgjegjës për buxhetit në Komunë pas miratimit të ligjit të buxhetit për vitin 2023, projektet kapitale të pa përfunduara nga vitet paraprake, nuk i kishin raportuar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve si projekte dhe obligimet të pa përfunduara për ti bërë ndryshimet e kërkua në tabelën 4.2 (financimi i investimeve kapitale komunale) Komuna në mungesë të ndarjeve buxhetore për këto projekte, gjatë vitit 2023 kishte realizuar pagesa nga fondet e projekteve tjera.

Kjo ka ndodhur si rezultat i menaxhimit jo të mirë të buxhetit, ekzekutimit, monitorimit dhe raportimit të projekteve kapitale

**Ndikimi** Shfrytëzimi i fondeve nga një projekt për pagesën e obligimeve të projektit tjetër duke anashkaluar procedurat ligjore rritë rrezikun që projektet e aprovuara të mos realizohen dhe në mos arrijen e objektivave të komunës.

**Rekomandimi A1** Kryetari duhet të sigurojë që të përforcohen kontrollet dhe të rritet përgjegjësia në procesin e ndarjes së fondeve për projektet kapitale, dukë i

dhënë prioritet projekteve të papërfunduara nga vitet paraprake.

### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja A2 - Anashkalimi i procedurave të prokurimit**

**Gjetja** Rregullorja nr. 001/2022 për prokurim publik, neni 55.10 Konkursi i projektimit fillohet me publikimin e njoftimit të konkursit për projektim të përgatitur sipas nenit 75 të LPP-së. Njoftimi i projektimit duhet të përmbajë: Nëse zbatohet procedura e hapur apo e kufizuar, dhe të gjitha informatat që kërkohen me procedurën e hapur apo të kufizuar; Nëse kandidatët duhet të posedojnë ndonjë kualifikim specifik profesional apo të barasvlershëm; Kriteret që do të zbatohen në vlerësimin e projekteve; Numrin dhe vlerën e shpërblimeve që do t'u jepen pjesëmarrësve; Nëse një kontratë pas konkursit do t'i jepet fituesit.

Ne katër (4) raste, komuna ka lidhur marrëveshje për projektimin dhe punimin skulpturave monumentale pa u aplikuar procedurat e prokurimit, por vetëm përmes thirrjes publik. Vlera e pagesës për këto projekte ishte 113,770€.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos funksionimit të duhur të kontrolleve të brendshme, që ka rezultuar me kontrata publike duke mos respektuar kërkesat ligjore.

**Ndikimi** Anashkalimi i procedurave të prokurimit, përveç që dëmtojnë konkurrencën, transparencën e procesit, efikasitetin dhe efektivitetin e veprimeve po ashtu rrisin rrezikun e mos arritjes së vlerës për paranë e shpenzuar dhe mundësisë së përballjes me vështirësi apo edhe humbje financiare të komunës.

**Rekomandimi A2** Kryetari duhet të sigurojë se janë zbatuar kërkesat e kornizës ligjore për procedurat e prokurimit për të gjitha punët të cilat janë objekt i prokurimit publik.

### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B3 - Mangësi lidhur me marrëveshjet për shërbime të veçanta**

**Gjetja** Neni 84 i Ligjit për Zyrtarët Publik Nr. 06/L-114, përcakton se, "Marrëveshjet për shërbime të veçanta, sipas paragrafit 4 të nenit 12 të Ligjit të Shërbimit Civil nr. 03/L-149 të Republikës së Kosovës, të lidhura para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të vlefshme deri në afatin e përcaktuar në ato marrëveshje në pajtim me dispozitat e lartcekura. Pas kësaj periudhe, marrëveshjet për shërbimet e veçanta lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik".

Në RVF Komuna raportoi se kishte 73 persona me marrëveshje për shërbime të veçanta, pra me një rritje nga viti i kaluar për 29 persona. Megjithatë, nga pesë (5) mostrat e testuara, kemi evidentuar se komuna nuk kishte zhvilluar procedurat e nevojshme të prokurimit publik për të angazhuar ata. Kontratat e nënshkuara në mes kryetarit dhe personelit të angazhuar përfshinin pozita si: zyrtar për projekte, zyrtar për leje

ndërtimore, koordinator për politika dhe marrëdhënie ndër-komunale, zyrtar i tatimeve në pronë, dhe zyrtar në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë.

Kjo ka ndodhur si pasojë mos funksionimit të kontrolleve të brendshme për të menaxhuar proceset në pajtueshmëri me kërkesat ligjore.

**Ndikimi** Mos zbatimi i kritereve të përcaktuara ligjore për angazhimin e personave me marrëveshje për shërbime të veçanta cenon parimin e konkurrencës, transparencës si dhe ndikon në diskriminimin e të tjerëve.

**Rekomandimi B3** Kryetari të sigurojë se me rastin e angazhimit të personave me marrëveshje për shërbime të veçanta, të respektohen kriteret sipas legjislacionit përkatës.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B4 - Mos verifikimi i plotë i pronave komunale**

**Gjetja** Neni 15 i Ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme parasheh që Komuna çdo vit duhet të kryejë veprime të inspektimit (verifikimit) për të paktën 20% e të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës.

Komuna i posedon rreth 36,485 objekte te regjistruara. Komuna në vitin 2023 kishte arritur të bëjë inspektimin (verifikimin) e vetëm 2,602 objekteve apo rreth 7.13%.

Komuna nuk ka ndërmarrë të gjitha masat ose veprimet alternative për verifikimin e 20% të pronave të paluajtshme/objekteve.

**Ndikimi** Inspektimi jo i plotë i pronave, mund të rezultojë me informata jo të plota të pronës së tatueshme aktuale si dhe të ndikoj në vlerësim jo të saktë të të hyrave për tatimin në pronë.

**Rekomandimi B4** Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B5 - Vonesa në kryerjen e obligimeve të papaguara dhe shpenzimet gjyqësore/përmbartimore**

**Gjetja** Neni 39.1 i Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësit parasheh se "ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore". Po ashtu neni 40.3 i Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit parash "Pas pranimit të vendimit të plotfuqishëm ose urdhrin të formës së prerë, Ministria është e autorizuar dhe ka përgjegjësinë që menjëherë të marrë çfarëdo masa të nevojshme për pagimin e vendimit ose urdhrin nga ndarjet buxhetore në dispozicion; me kusht që nëse vendimi i plotfuqishëm është nxjerrë kundër një komune, vetëm përvetësimet e komunës mund të shfrytëzohen për përmbartimin e këtij vendimi".

Nga testimi i mostrave, kemi vërejtur se në pesë (5) raste, faturat me vlerë totale prej 270,182€ nuk janë paguar brenda afatit ligjor prej 30 ditëve. Vonesat janë nga 50 deri 75 ditë kalendarik. Po ashtu duhet të theksojmë se si rezultat i shpronësimeve dhe mos kryerjes me kohë të obligimeve ndaj operatoreve ekonomik, shuma e pagesave të realizuara nga thesari, në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbartimore për shpronësimet ishte 665,980€. Prej tyre borxhi kryesor ishte 660,695€ ndërsa 5,385€ ishin shpenzime të interesit dhe procedurale të gjykatës/përmbartimit, ndërsa për vonesa në pagesën e faturave ishte 62,451€, prej tyre borxhi kryesor ishte 58,310€, ndërsa 4,141€ ishin shpenzime të interesit dhe procedurale të gjykatës/përmbartimit.

Kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk ka pasur mjete të mjaftueshme financiare dhe ka hyrë në obligime pa bërë ndonjë analizë të mirëfilltë buxhetore.

**Ndikimi** Vonesat në kryerjen e obligimeve kanë shkaktuar kosto shtesë, përveç vlerës së faturës komuna kishte paguar kosto shtesë përfshirë kamatën, interesin.

**Rekomandimi B5** Kryetari duhet të përmirësojë menaxhimin e fondeve për të siguruar që obligimet financiare kryhen në kohë dhe brenda afatit prej 30 ditëve, në mënyrë që ti shmanget shpenzimeve shtesë të interesit dhe kamatës.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B6 - Mos respektim i hapave për procedimin e pagesave**

**Gjetja** Neni 22 i Rregullës Financiare NR.01/2013/MF - Shpenzimi i parave publike, përcakton hapat për procedimin e pagesave, ku fillimisht bëhet Kërkesa për blerje, lëshohet Urdhër blerja, bëhet pranimi i mallit/shërbimit, pastaj Operatori Ekonomik sjellë faturën për pagesë.

Nga 46 mostrat e testuara në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, kemi vërejtur se në tetë (8) raste zotimi i mjeteve dhe urdhër-bleerja janë proceduar pas datës së faturës dhe pranimit të mallit, ndërsa në katër (4) raste të tjera vetëm urdhër-bleerja është proceduar pas datës së faturës dhe pranimit të mallit. Shuma totale e këtyre rasteve është 273,665€.

Kjo ka ndodhur si rezultat i kontrolleve jo efektive me rastin e procedimit të zotimit dhe urdhër blerjes.

**Ndikimi** Mos respektimi i hapave për procedimin e pagesave mund të shkakton rritjen e obligimeve komunale ndaj operatorëve ekonomik.

**Rekomandimi B6** Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve që zyra e prokurimit do të ndjek të gjithë hapat për procedimin e pagesave të përcaktuar me Rregullën Financiare për shpenzimin e parave publike.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.3.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra shërbime dhe komunalitë në vitin 2023 ishte 7,409,760€, prej tyre ishin shpenzuar 7,137,925€ apo 96%. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzimet komunale, derivatet dhe lëndët tjera për ngrohje, mirëmbajtje të objekteve, mirëmbajtje të rrugëve, servisimi i veturave, furnizime mjekësore etj.

#### Çështja A3 - Vonesa në vlerësimin e tenderëve

##### Gjetja

Sipas Rregullores Nr. 001/2022 Për Prokurim Publik, Neni 40, pika 3, Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, dhe nxjerrja e njoftimit mbi vendimin e AK, do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të arsyetuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh. Procesi i vlerësimit të tenderit do të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve.

Në dy (2) raste kemi vërejtur vonesa në vlerësimin e tenderëve siç janë:

- Në tenderin "Furnizim me laborator të shkencave natyrore" vlerësimi i tenderit për këtë procedurë tenderimi kishte zgjatur 60 ditë pas hapjes së ofertave; si dhe në tenderin "Furnizimi me dru" vlerësimi i tenderit për këtë procedurë tenderimi kishte zgjatur 45 ditë pas hapjes së ofertave.

Për të dy (2) rastet lartpërmendura, nuk kishte kërkesë nga komisioni për afat shtesë.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mbikëqyrjes dhe kontrolleve të pamjaftueshme nga komisioni vlerësues dhe për arsye të ndryshimit të udhëheqësit të Departamentit të Prokurimit.

##### Ndikimi

Vonesat në vlerësim të ofertave kanë ndikim negativ në realizim të objektivave dhe planifikimeve operationale.

##### Rekomandimi A3

Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve në mënyrë që komisioni vlerësues të kryejë vlerësimin e tenderëve brenda afatit 30 ditorë.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.3.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 9,155,997€, prej tyre ishin shpenzuar 6,398,850€ apo 70% Ato kanë të bëjnë me: ndërtimin e rrugëve lokale, ujësjellësve, kanalizimeve, parqeve nacionale, rregullimin e lumenjve etj.

### Çështja B7 - Regjistrat e menaxhimit të kontratave jo përmes platformës së e-prokurimit

<b>Gjetja</b>	<p>Pika 61 e Rregullës dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik parasheh që të Menaxhimi i Kontratës dhe Vlerësimi i performancës së kontraktuesve të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistemin e prokurimit elektronik.</p> <p>Komuna menaxhin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktuesve nuk e ka mbajtur dhe arkivuar përmes sistemit elektronik të prokurimit publik.</p> <p>Kjo kishte ndodhur si rezultat i kontrolleve të brendshme jo efektive në procesin e menaxhimit të kontratave përmes e-prokurimit.</p>
<b>Ndikimi</b>	<p>Mos mbajtja dhe arkivimi i kontratave përmes sistemit të prokurimit publik mund të ndikojnë në një menaxhim jo të mirëfillt të kontratave si dhe nuk ofron mundësi të mjaftueshme që menaxhmenti të marrë informata me kohë në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave.</p>
<b>Rekomandimi B7</b>	<p>Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për të siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet nga sistemi elektronik i prokurimit publik.</p>

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.3.3 Të arkëtueshmet

Komuna në vitin 2023 ka shpalosur në RVF llogaritë e arkëtueshme në vlerë 12,749,594€.

#### Çështja B8 - Dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme

**Gjetja** Sipas nenit 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme 06-L 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27 Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori. Arkëtimi i të hyrave tjera duhet të bëhet sipas afateve kohore të përcaktuara në faturë për secilin lloj të të hyrave.

Komuna nuk kishte menaxhim efektiv në mbledhjen e llogarive të Arkëtueshmeve (LIA). Për mostrat tona nuk kemi vërejt që komuna ka marr ndonjë veprim konkret për vitin 2023 për inkasimin e LIA. Pjesëmarrjen më të madhe të të arkëtueshmeve e ka tatimi në pronë me 10,637,315€, pastaj licencat e biznesit 1,743,601€, qiratë 330,067€ dhe të tjerat me 38,611€.

Kjo ka ndodhur për shkak se Komuna nuk ka ndërmarrë hapa konkretë ligjorë apo paralajmërues për të inkurajuar tatimpaguesit të shlyejnë borxhet e tyre. Në të njëjtën kohë, kjo situatë tregon edhe për mosfunksionimin e duhur të njësive përkatëse për menaxhimin e nevojshëm të të hyrave dhe llogarive të arkëtueshme.

**Ndikimi** Moszbatimi i mekanizmave të vendosur me ligj dhe rregullore ndikon në rritjen e vazhdueshme të kërkesave LL/A, gjë që rezultoi në më pak fonde për arritjen e qëllimeve dhe nxit debitorët e tjerë që të mos përmbyshin detyrimet e tyre.

**Rekomandimi B8** Kryetari duhet të marrë masat për të përmirësuar funksionimin e njësive përkatëse, me qëllim të sigurimit të një menaxhimi më të mirë të të hyrave dhe llogarive të arkëtueshme.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mbledhura nga kategoritë ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>6</sup>	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>32,599,281</b>	<b>37,495,073</b>	<b>34,111,198</b>	<b>32,109,663</b>	<b>28,862,333</b>
Grante Qeveritare - Buxheti	27,646,695	30,862,481	29,531,115	26,458,539	23,632,751
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	195,247	90,910
Të bartura nga viti i kaluar	0	1,565,676	1,290,241	1,650,040	695,640
Të hyrat vetanake	4,952,586	4,952,586	3,201,622	3,710,468	3,866,687
Donacionet vendore	0	13,202	8,855	46,462	7,569
Donacionet e jashtme	0	101,128	79,365	48,908	568,776

Buxheti final ishte më i lartë se buxheti fillestar për 4,895,792€. Kjo rritje është rezultat i pranimit të buxhetit nga donacionet, të hyrave të bartura nga viti paraprake dhe vendimeve të qeverisë. Në vitin 2023 komuna ka shpenzuar 91% të buxhetit final, me një zvogëlim prej 5% në krahasim me vitin 2022.

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>32,599,281</b>	<b>37,495,073</b>	<b>34,111,198</b>	<b>32,109,663</b>	<b>28,862,333</b>
Pagat dhe mëditjet	15,819,573	19,118,176	18,882,012	15,186,827	15,958,854
Mallrat dhe shërbimet	6,502,750	6,726,122	6,532,677	5,032,485	4,186,070
Komunalitë	646,800	683,639	605,132	568,787	588,601
Subvencionet dhe transferet	1,195,000	1,811,140	1,692,527	1,165,387	803,898
Investimet Kapitale	8,435,158	9,155,997	6,398,850	10,156,178	7,324,911



Buxheti final për paga dhe mëditje ishte rritur për 3,298,603€. Rritja ishte nga Vendimet e Qeverisë së Kosovës për rritjen e pagave në shumë 3,154,380€, rritje nga donacionet 4,222€ dhe rritje nga të hyrat vetjake 140,000€.


Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 223,372€. Rritja ishte nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara 201,740€, si dhe rritje nga donacionet për 21,631€.

Buxheti final për shpenzime komunale krahasuar me buxhetin fillestar është rritur për 683,639€ nga të hyrat vetjake të bartura nga viti 2022.

Buxheti final për subvencione ishte rritur për 616,140€ nga kjo vlerë: 474,964€ rritja nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2022, rritje me vendim të qeverisë 61,405€ dhe 79,771€ rritje nga donacionet.

Buxheti final për shpenzime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 720,839€. Kjo rritje vjen si rezultat hyrave vetjake të pa shpenzuara 712,134€ dhe rritja prej 8,705€ nga grandet e donatorëve.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat vetjake të planifikuara për vitin 2023 ishin 4,952,586€, përderisa ishin realizuar 6,667,379€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Po ashtu, komuna këtë vit ka pranuar të hyra nga gjobat nga trafiku dhe gjobat e gjykatës në vlerë totale prej 801.804€, si dhe të hyra nga Agjencioni i Pyjeve të Kosovës në vlerë 8,789€. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe realizojnë ministritë e linjës.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>4,952,586</b>	<b>4,952,586</b>	<b>6,663,515</b>	<b>4,245,470</b>	<b>4,837,641</b>
Të hyrat tatimore	2,938,283	2,938,283	3,088,495	2,484,945	2,312,933
Të hyrat jo tatimore	2,014,303	2,014,303	3,259,314	1,740,129	2,505,694
Të hyrat tjera	0	0	315,706	20,397	19,014

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2022 ka rezultuar me 15 rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023, 7 rekomandime janë zbatuar dhe 8 rekomandime nuk janë adresuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën e rekomandimeve nr. 4.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të shtojë kontrollet e brendshme për tu siguruar se zyrtarët e pasurive do ta regjistrojnë pasurinë nën 1,000€, në regjistrat kontabël të pasurive.	Nuk janë ndërmarre veprime të nevojshme	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Baza për opinion	Kryetari duhet të kërkojë llogaridhënie nga zyrtarët përgjegjës në pajtim me kërkesat ligjore dhe të ndërmerr masa të menjëhershme për tu siguruar se inventari i paguar sa më shpejt do të vendoset në QKMF.	Janë ndërmarre veprime	I zbatuar
3.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë se janë respektuar kërkesat ligjore lidhur me furnizimet/shërbimet, në mënyrë që edhe vendimet të jenë të bazuara mbi plotësimin e kushteve pasi të jenë kompletuar dokumentacioni i paraparë për pagesë.	Janë ndërmarre veprime	I zbatuar

4.	Baza për konkluzion	Kryetari me rastin e marrjes së shërbimeve nga operatorët ekonomik duhet të zbatoj ligjin dhe procedurat e prokurimit publik për tu siguruar se nuk është duke u reduktuar apo eliminuar konkurrenca në mes operatorëve ekonomik.	Janë ndërmarrë veprime.	I zbatuar
5.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për tu siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet nga sistemi elektronik i prokurimit publik.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimimi
6.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se do të ndërmerren veprimet për hartimin e planit vjetor për mbështetjen e OJQ-ve.	Janë ndërmarrë veprime	I zbatuar
7.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestinimi i mjeteve që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve më pas të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.	Nuk janë ndërmarrë veprime të nevojshme	Nuk ka filluar zbatimimi
8.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.	Nuk janë ndërmarrë veprime të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimimi
9.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari të sigurojë se me rastin e angazhimit të personave me marrëveshje për shërbime të veçanta, të respektohen kriteret sipas legjislacionit përkatës.	Nuk janë ndërmarrë veprime të nevojshme	Nuk ka filluar zbatimimi
10.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë se zyra e prokurimit do të ndjek të gjithë hapat për procedimin e pagesave të përcaktuar me Rregullën Financiare për shpenzimin e parave publike.	Nuk janë ndërmarrë veprime të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimimi
11.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë zyra e prokurimit aplikon procedurat e duhura të prokurimit ashtu siç parashihet me kërkesat ligjore.	Janë ndërmarrë veprime	I zbatuar
12.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të shtoj kontrollet për të siguruar që përmes menaxherit të kontratës do të bëhet mbikëqyrje e mirëfilltë e kontratave dhe pagesat mos të bëhet nga çertifikuesi pa u siguruar se kontrata po zbatohet në mënyrë që të mos bëhet tejkalimi i tyre.	Janë ndërmarrë veprime	I zbatuar
13.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e drejtë të kontrolleve të brendshme lidhur me regjistrimin e drejtë të pasurisë jo financiare kapitale në pajtim me kriteret e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare.	Janë ndërmarrë veprime	I zbatuar

14.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme në mënyrë të rritjes së efikasitetit në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme.	Nuk janë ndermarre veprimete nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin
15.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë shlyerjen e obligimeve të papaguara brenda afatit të paraparë.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Agron Fetiu, Ndhmës Auditor i Përgjithshëm



Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit



Fanol Hodolli, Udhëheqës i ekipit



Hysen Restelica, Anëtar i ekipit



Fetah Osmani, Anëtar i ekipit




## Shtojca I: Letër konfirmimi

### Letër konfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPAL GJILAN / GILAN BELEDIJE



#### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Gjiçanit, për vitin 2023 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem/ nuk pajtohem/ pajtohem pjesërisht/ me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.



Alban Hyseni  
Data: 22.05.2024, Gjiçan,

## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>7</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>8</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.



### Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionin i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionin

### Opinionin i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionin i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Pagesat: 1. Skulptures memoriale Heroina e Qytetit në shumë 16,968€; 2. Relievin Monumental "Drama Shqipe" në shumë 10,000€; 3. Relievin Monumental "Drama Shqipe" në shumë 6,802€; 4. skulptura monumentale Kadri Zeka 80,000€.
- <sup>6</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>7</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>8</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.